

ARTIKULLI #3

SEKTORI PRIVAT I KOSOVËS MERR ROL AKTIV NË PËRGATITJEN E STUDENTËVE PËR TREGUN E PUNËS


[APRIL 30TH, 2023]

Për më shumë foto mbi këtë artikull, shkoni në link:

<https://drive.google.com/drive/folders/1B5-7Xw79OIU-OyC0Rsfs-2iROjtt4z2>

Pas lansimit zyrtar të aktivitetit Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë (PSPFAL), ekipi i Konsorciumit të Iowa u bëri një vizitë bizneseve partnere. Ky aktivitet është mbështetur nga USAID dhe i zbatuar nga Universiteti i Iowa në partneritet me Universitetin Shtetëror të Iowa dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC). Vizitat në terren kishin synim kultivimin e mundësive për bizneset dhe universitetet publike që të bashkëpunojnë, në veçanti, në sektorët e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe atë të Bujqësisë. Këto partneritete të natyrës universitet-biznese do të adresojnë katër fusha kyçe: qasja në dhe shfrytëzimi i të dhënave relevante të tregut të punës nga universitetet, rishikimi i kurrikulave për të adresuar më mirë nevojat e industrisë, pasurimi i mundësive të mësimnxënies me përvojë për studentët, dhe lehtësimi i hulumtimit të aplikuar, të orientuar nga kërkesa.

“Ne do të punojmë së bashku për të lidhur studentët me dijën, dijën me industrinë, dhe industrinë me produktivitetin ekonomik. Ne besojmë që ky bashkëpunim, jo vetëm që do të jetë në të mirë të studentëve dhe industrisë, por edhe të shoqërisë së gjerë.” – Russell Ganim, Këshilltar Teknik për Aktivitetin, Prorektor i Asociuar në UI dhe Dekan i Programeve Ndërkombëtare në Universitetin e Iowa.



Ekipi i aktivitetit, duke bërë vizitë nëpër seksionet e ndryshme të Birrarisë Birra Peja – një prej partnereve të aktivitetit nga sektori privat. (Kjo foto, në veçanti, tregon hapësirën mbresëlënëse për mbushje të shisheve në birrari)

Aktiviteti ka krijuar marrëveshje partneriteti me nëntë prej bizneseve lidere në sektorët e TIK dhe bujqësisë në vend. Kjo strukturë fillestare e partnerëve të sektorit privat është baza e bashkëpunimit me biznesin. Me ecjen përpara të projektit, pritjet që partneritetet të rriten në mënyrë eksponenciale, ndërkohë që më shumë kompani kërkojnë të përfitojnë nga avansimet që universitetet bëjnë në përgatitjen e studentëve për profesionet e TIK dhe bujqësisë.

Gjatë vizitave fillimtare në Prizren dhe Pejë, vizitat tek bizneset partnere përfshinë Stone Castle (Rahovec), Birra Peja (Pejë), dhe partnerë nga Parku i Inovacionit dhe Trajnimeve (PIT) në Prizren. Vizitat në terren u dhanë ekipit një pamje nga afër të kapaciteteve dhe operimeve të sektorit privat, si dhe njohuri mbi ambicjet e tyre për të ardhmen. Bisedat e ekipit të Konsorciumit të IOWA ofruan informata të vlefshme mbi nivelin aktual të angazhimit të partnerëve të sektorit privat me institucionet e arsimit të lartë, sfidat me të cilat përballen gjatë bashkëpunimit, dhe vizionet dhe përkushtimi i tyre për partneritet më të afërt me universitetet në të ardhmen. Të gjithë partnerët shfaqën entuziazëm të madh për të mbështetur aktivitetin dhe për të bashkëpunuar me universitetet, duke ofruar mundësi për trajnime, vizita në terren, ligjerata në klasë, punë praktike, dhe mentorim për studentët.

“Një prej sfidave më të mëdha me të cilat përballemi tani është humbja e fuqisë punëtore. Të rinjtë po largohen nga vendi në kërkim të mundësive më të mira të punës në vende të huaja, duke e bërë gjithmonë e më të vështirë për ne të gjejmë dhe të mbajmë staf të aftë. Prandaj, kompania jonë do të përfitonte shumë nga ofrimi i punës praktike dhe mundësive të mentorimit për studentët universitar. Ne jemi të përkushtuar në zhvillimin e marrëdhënieve afatgjate të fuqishme, me talentin e ri nga fusha e bujqësisë, duke u mundësuar atyre të zhvillohen me ne dhe të bëhen kontributorë esencjal në prodhimtarinë tonë. Qoftë puna me tokë, monitorimi i vreshtave, bashkëpunimi me teknikë-laborantë, vlerësim të cilësisë, apo pjesëmarrje në shitje,

ne jemi të lumtur të akomodojmë sa më shumë studentë.” - Fejzullah Berisha, Menaxher i Verarisë Stone Castle.

Një prej vizitave interesante të ekipit, pas ceremonisë hapëse, ishte në Qendrën për Inovacion



Ekipi i aktivitetit duke eksploruar Verarinë mahnitëse Stone Castle, në Rahovec, duke u informuar ndërkohë mbi teknikat e deponimit të verës.

Makerspace në Prizren, një organizatë e dedikuar për zhvillimin dhe promovimin e ekosistemeve digjitale në Prizren. Për të dëshmuar entuziazmin e tyre për këtë aktivitet, Makerspace bujarisht ka ofruar ekspertizën dhe hapësirat e tyre për të mbështetur projektin përgjatë pesë vjetëve në vijim. Misioni i Makerspace në mënyrë të përkryer përputhet me objektivat e aktivitetit, meqë ata synojnë të plotësojnë hendekun mes shkencës, arsimit, dhe sektorëve të industrisë dhe biznesit. Vlen të përmendet që ata tashmë kanë marrë rolin udhëheqës në krijimin e partneriteteve më të fuqishme mes arsimit të lartë dhe sektorit privat në Prizren, pasi që aktualisht ata mbajnë pozitën udhëheqëse në Bordin Industrial për TIK në Universitetin e Prizrenit.

“Objektivi ynë është të tërheqim një gamë të gjerë të bizneseve, që t’i bashkohen Bordit Industrial të TIK për Universitetin e Prizrenit, dhe ajo që është më e rëndësishmja, t’u ndihmojmë të kuptojnë përfitimet e bashkëpunimit. Për këtë qëllim, ne me sukses kemi krijuar grupe hulumtimi, që përbëhen nga anëtarë si nga universiteti, ashtu edhe bizneset. Ne besojmë që gradualisht jemi duke shkuar drejt bashkëpunimeve të frytshme dhe inovacionit. Synimi ynë që të shërbejmë si katalizator drejt forcimit të lidhjeve mes këtyre dy komuniteteve, duke i mbajtur të informuar rreth mundësive të bashkëpunimit dhe trendeve të fundit në tregun e TIK. Përgjatë dy viteve të ardhshme, ne synojmë të sigurohemi që këto biznese të kenë kuptuar se si të shfrytëzojnë kapacitetet e universitetit, dhe gradualisht, të marrin rolin udhëheqës në krijimin e partneriteteve me ekipe hulumtimi dhe studentë të universitetit për sipërmarrjet e tyre të

ardhshme biznesore..” Enis Qafëleshi, Drejtor Ekzekutiv, Qendra për Inovacion Makerspace, Prizren.



Partnerët e sektorit privat, të cilët kanë zotuar mbështetjen e tyre për këtë aktivitet, kanë treguar vullnet të jashtëzakonshëm për të bashkëpunuar ngushtë me universitetet dhe me ekipin e aktivitetit. Takimet fillimitare me disa prej bizneseve partnere kanë mbushur ekipin me shpresë, dhe kanë ofruar informata dhe njohuri të vlefshme se si të organizohen aktivitetet dhe punëtoritë e planifikuara të projektit. Ekipi është i lumtur të shoh pasionin dhe profesionalizmin e demonstruar, si nga universitetet, ashtu edhe bizneset, pasi që besojnë që ky bashkëpunim është një hap jetik drejt përmirësimit të sistemeve të tregut në sektorët e TIK dhe Bujqësisë në Kosovë.